



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:005751

Datë: 07.08.2024

Numri i dokumentit: 06028726

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Dardan Maloku, me zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale ndaj të pandehurës personit juridik IMK... SHPK me seli në Ferizaj Rr. "...” dhe personit përgjegjës A.B., me vendbanim në Prishtinë Rr.””, duke vendosur lidhur me marrëveshjen e ndërmjetësimit me nr. ND. .../24, të datës 01.08.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurës personit juridike IMK –....SHPK të cilën e përfaqëson av. Selman Bogaj, personi përgjegjës A.B. të cilin e përfaqëson av.Adnan Pacolli në njërën anë dhe të dëmtuarit E.H., në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.40-10/19, të datës 11.03.2020, për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtës dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 3 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK), në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale (tani e tutje KPP) dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seance, më datë 07.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr..../2024, e datës 01.08.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, në mes të pandehurës personit juridik IMK-SHPK me seli në Ferizaj Rr. "...” dhe personit përgjegjës A.B., me vendbanim në Prishtinë Rr.” ...”,
i lindur me datë ..., me numër personal ... në njërën anë dhe të dëmtuarit E.H. në anën tjetër.
- II. Hudhet** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.40-10/19 e datës 11.03.2020, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurës personit juridik IMK-SHPK dhe personit përgjegjës A.B. për shkak të

veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 3 të KPRK-së.

III. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.40-10/19 të datës 11.03.2020, e ka akuzuar të pandehurën personin juridik IMK-SHPK dhe personin përgjegjës A.B., për veprën penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 3 të KPRK-së.

Më datë 17.07.2024, është mbajtur shqyrtimi gjyqësor dhe në këtë shqyrtim gjyqësor bazuar në nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim palët kanë propozuar që kjo çështje penale të zgjidhet përmes procedurës së ndërmjetësimit. Gjykata e ka aprovuar propozimin e palëve dhe bazuar në nenin 229 paragrafi 1 të KPP-së, e ka referuar çështjen në ndërmjetësim.

Më datë 01.08.2024 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr. .../2024, në mes të pandehurës personit juridik IMK-SHPK me seli në Ferizaj Rr.”...” dhe personit përgjegjës A.B., me vendbanim në Prishtinë rr.” ...”, i lindur me datë ..., me numër personal në njëerën anë dhe të dëmtuarit E.H. në anën tjetër.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim KPP-në dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, dhe kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga të gjitha të lartcekurat, e në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

2020:005752, datë 07.08.2024

Zyrtarja ligjore,

Ardita Tasholli

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.